

LIGJ
Nr.8435, datë 28.12.1998

PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

(Ndryshuar me ligjin nr. Nr.8508, datë 7.7.1999; nr. 8519, datë 30.7.1999; nr.8552, datë 18.11.1999; nr. 8581, datë 17.2.2000; 8651, datë 28.7.2000; nr. 8713, datë 15.12.2000; nr. 8840, datë 11.12.2001; nr. 8858, datë 14.2.2002; nr. 8915, datë 27.6.2002; nr. 8917, datë 4.7.2002)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 81, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

Neni 1

Në Republikën e Shqipërisë, sistemi i taksave përbëhet nga taksat kombëtare dhe taksat vendore.

Neni 2

(Shtuar pika 23 me ligjin nr. nr. 8581, datë 17.2.2000; ndryshuar pika 13 me ligjin nr. 8651, datë 28.7.2000; nr. 8713, datë 15.12.2000; ndryshuar me pikat 7, 9 dhe 23 me ligjin nr. 8840, datë 11.12.2001; shfuqizuar pika 22 me ligjin nr. 8858, datë 14.2.2002; shtuar pikat 25, 26 dhe 27 me ligjin nr. 8915, datë 27.6.2002)

Në taksat kombëtare bëjnë pjesë:

1. Taksat portuale.
2. Taksat për shërbimet konsullore.
3. Taksa vjetore e tonazhit të automjeteve për aks.
4. Taksa për qarkullimin e automjeteve të huaja.
5. Taksa vjetore për regjistrimin e përvitshëm të automjeteve.
6. Taksa për importimin e automjeteve të përdorura.
7. Taksat për pajisjen me leje drejtimi për drejtim automjeti.
8. Taksa për përdorimin e aparateve radiotelevizive.
9. Taksa për përdorimin e numrit telefonik.
10. Taksa për veprime e shërbime nga administrata gjyqësore, e Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë, noteria dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
11. Taksa për regjistrimin në arsimin e lartë.
12. Taksa për shërbimet e radiokomunikacioneve.
13. Taksa vjetore për shërbimet e transmetimeve radio e televizive.
14. Taksa për kalimin e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë me avion.
15. Taksa për pajisjen me pasaportë lundrim të personave.
16. Taksa për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit.
17. Taksa e regjistrimit për ushtrimin e lotarive të konkurseve parashikuese dhe lojërave

të fatit.

18. Taksa e akteve dhe e pullës.
19. Taksa për ulje-ngritjen e avionëve dhe qëndrimin e tyre në aeroport.
20. Taksa për mbikalimet ajrore të avionëve mbi territorin e Republikës së Shqipërisë.
21. Taksa e rentes minerare (Royalty).
22. Shfuqizuar.
23. Taksa për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasurinë e luajtshme (automjetet).
24. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
25. Mbitaksa për importet e taksueshme.
26. Taksa mbi konsumin e karburantit.
27. Taksa vjetore nga tatimpaguesit e TVSH-së për ndërtimin e Rrugës Durrës-Kukës.

Neni 3

Në taksat vendore bëjnë pjesë:

Taksat e bashkisë dhe të komunës:

1. Taksa e regjistrimit për veprimtari të ndryshme.
2. Taksa e pastrimit, largimit dhe kompostimit të mbeturinave.
3. Taksa e fjetjes në hotel të të huajve.
4. Taksa tregu për zënie vendi.
5. Taksa e xhiros për restorante, diskoteka, hotele, kafene, bar-bufe e ëmbëltore.
6. Taksa e reklamës.
7. Taksa e tabelës.
8. Taksa për bagëti të therrur.
9. Taksa për mbajtjen e qenve të luksit.
10. Taksa regjistrimi për vendbanimin e ri.
11. Taksa e parkimit të automjeteve.
12. Taksë gjuetie dhe peshkimi amator.
13. Taksë për ndërtime të reja.

Neni 4

Në bazë të nenit 113 të Kushtetutës, këshilli i bashkisë dhe i komunës, kur e gjykon të domosdoshme, mund të vendosë taksa me karakter të përkohshëm, për shërbime të reja, në interes të banoreve të territorit që mbulon. Të tilla taksa mund të vendosë edhe këshilli i i qarkut, pasi të ketë marrë, më parë, miratimin e këshilli të bashkisë ose të komunës, në të cilat ofrohet ky shërbim.

Neni 5

Të ardhurat që realizohen nga taksat kombëtare derdhen në buxhetin e shtetit, kurse ato që realizohen nga taksat vendore derdhen në buxhetin e rrethit, të bashkisë e komunës.

KREU II

Neni 6

(Shtuar shkronja “s” me ligjin nr. nr. 8581, datë 17.2.2000; ndryshuar shkronja “k” me ligjin nr. 8651, datë 28.7.2000; shtuar shkronja “t” me ligjin nr. 8713, datë 15.12.2000; ndryshuar shkronjat “e”, “f”, “gj”, “k”, “q” dhe “s” të pikës I dhe shtuar paragraf në fund

të pikës II me ligjin nr. 8840, datë 11.12.2001; shfuqizuar shkronja “r” me ligjin nr. 8858, datë 14.2.2002; shtuar shkronjat “u”, “v” dhe “x” me ligjin nr. 8915, datë 27.6.2002)

Niveli i taksave të jetë si më poshtë:

I. Taksat kombëtare

a) Anijet, të cilat kryejnë veprime tregtare, sa herë që prekin portet dhe radat e Republikës së Shqipërisë, paguajnë taksa portuale, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij ligji, dhe është pjesë përbërëse e tij.

Veprime tregtare të anijeve quhen ngarkimi ose shkarkimi i mallrave, zbarkimi dhe imbarkimi i udhëtarëve për transport.

Nuk quhen veprime tregtare:

- riparimi ose dokimi i anijeve;
- zbarkimi i personave të transportuar nga anija, të cilët ndiqen nga autoritetet përkatëse ligjore;

- zbarkimi ose imbarkimi i pjesëtarëve të ekuipazheve të anijeve dhe të personave të sëmurë dhe të vdekur;

- ngarkimi ose shkarkimi i mallrave të përfaqësive të trupit diplomatik të akredituar në Republikën e Shqipërisë dhe të përfaqësive tona diplomatike jashtë vendit;

- furnizimi i anijeve me ujë të pijshëm, sende ushqimore, karburante e lubrifikante, materiale e pjesë ndërrimi etj.;

- ndalesat në porte të anijeve për shkak të kohës së keqe, avarive të ndryshme dhe veprimeve në ndihmë të tyre nga anijet e tjera;

- hyrja në porte pa ngarkesë të anijeve të personave fizikë e juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

b) Taksat për shërbimet konsullore caktohen sipas lidhjes nr.2, e cila i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Taksa vjetore e tonazhit të automjeteve për aks caktohet sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

d) Taksa për qarkullimin e automjeteve të huaja caktohet sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

dh) Taksa për regjistrimin e përvitshëm të automjeve caktohet sipas lidhjes nr.5, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

e) Taksa për importimin e automjeteve të përdorura caktohet:

Për mjetet e prodhuara deri më 31 dhjetor 1990.

1. Për autoveturat: 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

2. Për mjetet e tjera për transportimin e jo më shumë se 10 personave, furgonë, mikrobusë dhe mjete të tjera për transportimin e mallrave me peshëmbajtje deri në 5 tonë: 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë.

3. Për autobusët dhe mjetet e tjera për transportimin e mallrave me peshëmbajtje mbi 5 tonë: 100 000 (njëqind mijë) lekë.

4. Për traktorët rrugorë (kokat tërheqëse) 40 000 (dyzet mijë) lekë.

Për mjetet e prodhuara nga 1 janari 1991:

1. Për autovetura: 40 000 (dyzet mijë) lekë.

2. Për mjetet e tjera për transportimin e jo më shumë se 10 personave, furgonë, mikrobusë dhe mjete të tjera për transportimin e mallrave me peshëmbajtje deri në 5 tonë: 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

3. Për autobusët dhe mjetet e tjera për transportimin e mallrave me peshëmbajtje mbi 5 tonë: 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

4. Për traktorët rrugorë (kokat tërheqëse): 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

f) Taksat për pajisjen me leje drejtimi për drejtimin e automjeteve caktohen:

1. Për leje drejtimi të kategorisë A.....3 000 (tre mijë) lekë
2. Për leje drejtimi të kategorisë B... 4 500 (katër mijë e pesëqind) lekë
3. Për leje drejtimi të kategorisë C.....2 000 (dy mijë) lekë
4. Për leje drejtimi të kategorisë D... .. 3 000 (tre mijë) lekë
5. Për leje drejtimi të kategorive BE,CE dhe DE..... 3 000 (tre mijë) lekë
- g) Për përdorimin e aparaturave radiotelevizive nga çdo zotërues caktohet:
Për marrësit radiofonike.....100 (njëqind) lekë në vit
Për marrësit televizivë.....400 (katërqind) lekë në vit

Kjo taksë paguhet nga përdoruesit familjarë vetëm për një marrës radioteleviziv, pavarësisht nga numri i aparateve që mund të ketë në familje. Për përdoruesit e tjerë kjo taksë paguhet për çdo aparat marrës.

gj) Taksa për përdorimin e numrit telefonik:

1. Për telefoninë kablllore, nga çdo zotërues në masën 200 (dyqind) lekë në vit.
2. Për telefoninë celulare me kontratë, nga çdo zotërues në masën 400 (katërqind) lekë në vit.

3. Për telefoninë celulare me parapagim (kartë), nga çdo zotërues në masën 700 (shtatëqind) lekë vetëm në çastin e shitjes së numrit.

h) Taksat për veprimet e shërbimit nga administrata gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë, noteria dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme caktohen sipas lidhjes nr.6, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

i) Për regjistrimin në arsimin e lartë paguhet një taksë 100 lekë për çdo vit shkollor.

j) Taksat për shërbimet e radiokomunikacioneve caktohen sipas lidhjes nr.7, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

k) Taksat vjetore për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive caktohen sipas lidhjes 11, që i bashkëlidhet këtij ligji.

l) për kalimin e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë me avion, për të udhëtuar në shtetet e tjera, nga shtetasit e huaj paguhet, për çdo kalim, një taksë prej 10 dollarësh USA, ose kundravlera e 10 dollarëve USA në monedhë të huaj, tërësisht të konvertueshme, sipas kursit mujor të këmbimit të dollarit USA me monedhat e tjera, dërguar nga Drejtoria e Doganave, ndërsa për shtetasit shqiptarë taksa është 1 000 (një mijë) lekë për çdo kalim.

m) Taksa për pajisjen me pasaportë lundrimi caktohet 750 (shtatëqindpesëdhjetë) lekë për çdo person.

n) Taksa për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit caktohet sipas lidhjes nr.8, e cila i bashkëlidhet këtij ligji edhe është pjesë përbërëse e tij.

nj) Taksa e regjistrimit për ushtrimin e lotarive të konkurseve parashikuese dhe e lojërave të fatit, caktohet 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë në vit.

o) Taksa e akteve dhe e pullës caktohet sipas lidhjes nr.6, e cila i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

p) Taksat për uljë-ngritjen e avionëve dhe qëndrimin e tyre në aeroport caktohen sipas lidhjes nr.9, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

q) Taksa e mbikalimeve ajrore të avionëve mbi territorin e Republikës së Shqipërisë llogaritet në bazë të njësive “unit rate” (kosto bazë) që caktohet çdo vit nga Eurokontrolli. Vetëm për vitin 2002 taksa e mbikalimeve ajrore do të mbetet në masën 100 dollarë për çdo mbikalim.

r) Shfuqizuar.

rr) Masa e taksës së rentës minerare është sipas ligjit nr.7796, datë 17.2.1994

s. Taksa e kalimit të së drejtës të pronësisë të pasurisë së luajtshme (automjete) është në masën 2 për qind të vlerës së kalimit të pasurisë dhe ajo paguhet në çastin e kryerjes së aktit të

kalimit të pronësisë. Për mjetet e prodhuara deri në 10 vjet nga çasti i kalimit të pronësisë, taksa është 2 për qind e vlerës, por jo më pak se 10 000 (dhjetë mijë) lekë, ndërsa për mjetet e prodhuara mbi 10 vjet nga çasti i kalimit të pronësisë, taksa është dy për qind e vlerës, por jo më pak se 5 000 (pesë mijë) lekë.

t) Taksa mbi kalimin e së drejtës të pronësisë për pasuritë e paluajtshme llogaritet:

- për ndërtesat: në lekë për metër katror për sipërfaqe ndërtimi të shitur;
- për pasuritë e tjera të paluajtshme në përqindje mbi vlerën e pasurisë së shitur.

Taksa mbi kalimin e së drejtës të pronësisë në ndërtesa caktohet:

- për Bashkinë e Tiranës në masën 2 000 lekë për metër katror për sipërfaqe ndërtimi të shitur të destinuar për biznes, ndërsa për sipërfaqe ndërtimi të shitur të destinuar për banim 1000 lekë për metër katror;

- për bashkitë e kategorive I dhe II në masën 500 lekë për metër katror për sipërfaqe ndërtimi të shitur;

- për bashkitë e kategorive III dhe IV dhe për të gjitha komunat 200 lekë për metër katror për sipërfaqe ndërtimi të shitur.

Taksa mbi kalimin e pronësisë në pasuritë e tjera të paluajtshme caktohet në masën 2 për qind të vlerës së shitjes.

Taksa mbi kalimin e së drejtës të pronësisë për pasuritë e paluajtshme paguhet nga të gjithë personat fizikë dhe juridikë që kalojnë këtë të drejtë, që shesin pasuri të tilla, me përjashtim të individëve, të cilët paguajnë tatim mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat.”

u. Mbitaksa për importet e taksueshme caktohet në masën 1 për qind për të gjitha mallrat e importuara dhe të taksueshme.

v. Taksa mbi konsumin e karburantit caktohet në masën 3 lekë për litër për gazoilin, benzinën dhe benzolin e importuar, si dhe për ata të prodhuar në vend.

x. Taksa vjetore për tatimpaguesit e TVSH-së për ndërtimin e Rrugës Durrës-Kukës caktohet në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë në vit, e cila derdhet sipas afateve të përcaktuara për taksat vjetore.

Kjo taksë do të fillojë të zbatohet më 1 janar 2001.

II. Taksat vendore

a. Taksa e regjistrimit për veprimtari të ndryshme caktohet si vijon:

1. Për veprimtaritë private të personave fizikë, që bëjnë tregti e kryejnë shërbime ambulante, 2 000 (dy mijë) lekë.

2. Për personat fizikë e juridikë, shtetërorë e privatë, vendas e të huaj 20 000 (njëzet mijë) lekë.

b. Taksa e pastrimit, largimit dhe kompostimit të mbeturinave caktohet:

1. Për çdo familje 300 (treqind) lekë në vit.

2. Për çdo njësi tregtare:

2.1 Për bulmet, mish, peshk 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në vit;

2.2 Për fruta, perime, ushqimore 10 000 (dhjetë mijë) lekë në vit;

2.3 Për artikujt industrialë 5 000 (pesë mijë) lekë në vit.

3. Për bare, restorante, kafene,

bar-bufe, diskoteka, lojëra fati etj. 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në vit;

4. Për hotele, motele, komplekse turistike

500 (pesëqind) lekë për çdo dhomë në vit.

5. Për konvikte, pensione, shtëpi pushimi, shtëpi fëmijësh, spitale, maternitete, për çdo dhomë:

5.1 shtetërore 20 lekë në vit

- 5.2 private 500 lekë në vit
6. Për mjedise administrative (zyra, salla mbledhjesh etj.) për çdo dhomë:
- 6.1 shtetërore 50 lekë në vit
- 6.2 private 250 lekë në vit
7. Për institucionet kulturore e sportive:
- 7.1 Për institucionet social-kulturore 10 000 (dhjetë mijë) lekë në vit për çdo njësi.
- 7.2 Për institucionet sportive, ekspozita dhe panaire të ndryshme 20 000 (njëzet mijë) lekë në vit për çdo njësi.
8. Për çdo njësi shërbimi dhe artizanati:
- 8.1 Kur veprimtaria klasifikohet si biznes i vogël 5 000 (pesë mijë) lekë në vit për çdo njësi;
- 8.2 Kur veprimtaria klasifikohet me TVSH 20 000 (njëzet mijë) lekë në vit për çdo njësi.
9. Për çdo njësi prodhimi:
- 9.1 Kur veprimtaria klasifikohet si biznes i vogël 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në vit për çdo njësi;
- 9.2 Kur veprimtaria klasifikohet me TVSH 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë në vit për çdo njësi.
10. Për subjekte ndërtimi 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë në vit për çdo njësi.
11. Për gjithë personat që klasifikohen si ambulantë 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë në vit.
- Të ardhurat e krijuara nga taksat vendore sipas pikës "b" "taksa e pastrimit, largimit dhe kompostimit të mbeturinave", përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë vendosur këto taksa.
- c) Taksa për fjetjen në hotele caktohet në masën 10 për qind mbi çmimin e fjetjes, për çdo natë fjetjeje, vetëm për shtetasit e huaj. Kur në çmimin e fjetjes përfshihet edhe mëngjesi, ky i fundit zbritet nga vlera.
- ç) Taksa e tregut për zënie vendi caktohet:
1. Ditore:
- 1.1 Për fruta, perime, vezë, 40 lekë për metër katror në ditë.
- 1.2 Për bulmet, mish, peshk 50 lekë për metër katror të zënë, në ditë.
- 1.3 Për artikujt industrialë 30 lekë për metër katror të zënë, në ditë.
2. Për zënie vendi, me karakter të përhershëm, bashkitë, komunat mund të organizojnë ankande të hapura për subjektet e interesuara, duke marrë si çmim bazë vlerat e përcaktuara në pikën 1, të shkronjës "ç" të këtij neni, për një periudhë jo më pak se një muaj dhe jo më shumë se një vit dhe nuk mund ta rijapë këtë vend me qira të tretëve.
- d) Taksa e xhiros për restorante, kafene, bar-bufe, diskoteka, hoteleri e ëmbëltore në masën 1 për qind të xhiros së kryer nga çdo njësi.
- dh) Taksa e reklamës caktohet:
1. Për reklama të zakonshme:
- Për Tiranën 11 000 (njëmbëdhjetë mijë) lekë për metër katror në vit.
- Për bashkitë e kategorisë së parë 10 000 (dhjetë mijë) lekë për metër katror në vit.
- për bashkitë e kategorisë së dytë, të tretë dhe të katërt, si dhe komunat e kategorisë së parë, të dytë dhe të tretë 5 000 (pesë mijë) lekë për metër katror në vit.
2. Për reklamat elektronike 20 000 (njëzet mijë) lekë për metër katror në vit.
- e) Taksa e tabelës caktohet:

1. Për tabelat e shkruara në gjuhën shqipe:
 - 1.1 Për personat fizikë e juridikë 500 (pesëqind) lekë në vit.
 - 1.2 Për tabelat e shkruara në gjuhë të huaj caktohet 1500 (njëmijë e pesëqind) lekë në vit.
- ë) Taksa për çdo bagëti të therrur në vendet e caktuara nga komuna, bashkia caktohet:
 1. Për bagëti të trasha e derra 50 lekë për kokë të therrur;
 2. Për bagëti të imta 20 lekë për kokë të therrur.
- f) Taksa për mbajtjen e qenve të luksit caktohet - 10 000 (dhjetë mijë) lekë në vit, me dhënien e certifikatës përkatëse.
- g) Taksa e regjistrimit për vendbanimin e ri caktohet për çdo familje:
 1. Në Tiranë 5 000 (pesë mijë) lekë /regjistrim.
 2. Në rrethet e kategorisë së parë 3 000 (tre mijë) lekë /regjistrim.
 3. Në rrethet e kategorisë së dytë 2 000 (dy mijë) lekë /regjistrim.
- gj) Taksa për ndërtimet e reja caktohet 15 lekë për metër katror mur i jashtëm për çdo ndërtëse të re, sipas projektit të miratuar gjatë marrjes së lejes së ndërtimit.
- i) Taksa e gjuetisë dhe e peshkimit amator 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë në vit për çdo leje të dhënë.
- j) Masa e taksës për parkimin e automjeteve për një orë caktohet:

	Bashkia Tiranë	Bashkitë e kateg. I-II	Bashkitë e categ. III-V dhe komuna me qytete
1. Autobusat e të gjitha llojeve	100 lekë	50 lekë	30 lekë
2. Mikrobusat:			
- Autotaksi	8-10 vende	20 20	15
- Minibuse të tjera, të çdo lloji	30	20	15
3. Autoveturat			
- Taksi	20	10	10
- Shtetërore dhe private	10	10	10
4. Kamione			
- deri 3.5 tonë	10	10	10
- mbi 3.5 deri 8 tonë	15	15	15
- mbi 8 deri 14 tonë	20	20	20
- mbi 14 tonë	50	25	25

Për Bashkinë e Tiranës, niveli i taksave të shkronjës “b” pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, shkronjës “dh”, pika 1, 2 dhe shkronjës “e” pika 1, të përlllogaritet sipas ndarjes së territorit në zonat A, B, C si më poshtë:

- Për zonën A niveli i taksës shumëzohet me koeficientin 1, 2
- Për zonën B niveli i taksës shumëzohet me koeficientin 1,1
- Për zonën C niveli i taksës shumëzohet me koeficientin 1.

Zonat A, B dhe C klasifikohen nga zyrat e urbanistikës në Bashkinë e Tiranës, në përputhje me zhvillimin urbanistik dhe ekonomik të tyre. Këto zona miratohen nga Këshilli i Rregullimit të Territorit në Bashkinë e Tiranës.

Këshillat e qarkut, bashkiak, komunal kanë të drejtë që, brenda masës së taksës vendore, të miratuar me këtë ligj, të bëjnë ndryshime në të, në masën +/- 20 për qind.

KREU III AGJENTËT TATIMORË PËR VJELJEN E TAKSAVE

Neni 8

(Ndryshuar pika 3 dhe 17 me ligjin nr. nr. 8581, datë 17.2.2000; shtuar paragrafi I dytë dhe pika 23 dhe ndryshuar pika 10 me ligjin nr. 8713, datë 15.12.2000; ndryshuar pikat 1, 3, 12, 17 dhe 20 dhe pika 3 në fund të nenit si dhe shtuar pika 24 me ligjin nr. 8840, datë 11.12.2001)

Taksa vjetore është e menjëhershme dhe paguhet brenda tremujorit të parë të vitit në vazhdim.

Agjentët e taksave janë të detyruar të derdhin në buxhet taksat e vjela brenda datës 30 të muajit, në të cilin taksat janë arkëtuar.

Kur detyrimi për pagimin e taksave vjetore lind 6-mujorin e parë, do të paguhet 100 për qind të taksës, ndërsa kur ky detyrim lind në 6-mujorin e dytë do të paguhet 50 për qind të masës së këtyre taksave.

Taksat e shërbimeve me karakter administrativ, gjyqësor, të prokurorisë, noteriale, të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme paguhen me anë të pullës, ndërsa taksa e kalimit të kufirit të Republikës së Shqipërisë me avion, taksa për solidaritetin për mbrojtjen dhe rendin për shtetasit shqiptarë, që dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë, paguhen me anë të biletave të taksës.

Taksat arkëtohen nga organi që kryen shërbimin dhe derdhen qind për qind në buxhet. Në këto raste organet shtetërore dhe private veprojnë si agjente tatimore për mbledhjen e taksave. Personave juridikë shtetërorë dhe personave juridikë e fizikë, privatë u jepet një përqindje e caktuar e masës së taksave të vjela, si më poshtë:

A. Për taksat kombëtare

- | | | |
|---|-------------|----------------------------------|
| 1. Për taksat portuale (kapitenerisë së porteve) | 4 për qind | |
| 2. Për taksat për shërbimet konsullore | | 3 për qind |
| 3. Për taksën vjetore të tonazhit të automjetit për aks, 22 për qind e cila ndahet: | | |
| - Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor | 20 për qind | |
| - Drejtoria e Qarkullimit Rrugor pranë Ministrisë së Rendit Publik | 2 për qind | |
| 4. Për taksën për qarkullimin e automjeteve të huaja | | 3 për qind |
| 5. Për taksën për përdorimin e aparateve radiotelevizive | | 5 për qind |
| 6. Për taksën për përdorimin e aparateve telefonike | | 5 për qind |
| 7. Për taksat për veprimet e shërbimit nga administrata gjyqësore, e Ministrisë së Drejtësisë, prokuroria, noteria dhe hipotekat nga kjo: | | 5 për qind |
| - Për organet gjyqësore dhe hipotekat | 2 për qind | Për organet noteriale 0 për qind |
| - Për subjektet, të cilat janë të autorizuar sipas ligjit nr. 8002, datë 27.9.1995 "Për përdorimin dhe administrimin e pullave të taksave" për shitjen e pullave të taksës. | | 3 për qind |
| 8. Për taksën e regjistrimit në arsimin e lartë | | 2 për qind |
| 9. Për taksën për shërbimet e radiokomunikacioneve | | 5 për qind |

10. Për taksën vjetore për licensimet radiotelevizive	5 për qind.
11. Për taksën e kalimit me avion të kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë	3 për qind
12. Për taksën për pajisje me leje drejtimi për drejtim automjeti	5 për qind
13. Për taksën për pajisjen me pasaportë lundrimi	0 për qind
14. Për taksën për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit	5 për qind
15. Për taksën e regjistrimit për ushtrimin e lotarive të konkurseve parashikuese dhe të lojërave të fatit me karakter kombëtar	0 për qind
16. për taksën e akteve dhe të pullës	5 për qind
17. Për taksën e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve, e cila ndahet:	22 për qind
-Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor	20 për qind
-Drejtoria e Qarkullimit Rrugor pranë Ministrisë së Rendit Publik	2 për qind
18. Për taksën për importimin e automjeteve të përdorura	0 për qind
19. Për taksën për ulje-ngritjen e avioneve dhe për qëndrimin e tyre në aeroport	3 për qind
20. Nga të ardhurat e vjela nga taksa e mbikalimeve ajrore në territorin e Republikës së Shqipërisë përqindja që do t'i jepet Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror të jetë 80 për qind	
Nga kjo përqindje jo më pak se 70 për qind të jetë për investime.	
21. Për taksën e rentës minerare (Royalty)	0 për qind
22. Për taksën mujore për solidaritetin për mbrojtjen dhe rendin	0 për qind
23. Për taksën mbi kalimin e së drejtës të pronësisë për pasuritë e paluajtshme	3 për qind.
24. Për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e luajtshme (automjetet)	8 për qind.

B. Për taksat vendore:

1. Për taksën e pastrimit, largimit dhe kompostimit të mbeturinave	5 për qind
2. Për taksën e tregut për zënie vendi	5 për qind
3. Për taksën e gjuetisë dhe peshkimit amator	5 për qind
4. Për taksën e fjetjes në hotel të të huajve	0 për qind
5. Për taksën për regjistrimin e veprimtarisë private	0 për qind
6. Për taksën e reklamës	5 për qind
7. Për taksën për çdo bagëti të therrur	5 për qind
8. Për taksën për ndërtime të reja	5 për qind
9. Për taksën e tabelës	5 për qind
10. Për taksën e bashkisë për xhiron e hoteleve, ëmbëltove, diskotekave, restoranteve dhe kafeneve	0 për qind
11. Për taksën për mbajtjen e qenve të luksit	5 për qind
12. Për taksën për regjistrimin e vendbanimit të ri	0 për qind
13. Për taksën për parkimin e automjeteve	5 për qind

Këto shuma do të përdoren:

1. Në formën e shpërblimit mbi pagën për vështirësi në punë deri në masën 20 për qind

të pagës, për punonjësit që do të shërbejnë si agjentë tatimore. Punonjësit, që përfitojnë këto shpërblime, përcaktohen nga drejtuesit e subjekteve.

2. Në formën e pagës ku merren punonjës të rinj, për të përballuar vjeljen e taksave.

3. Për mekanizimin, informatizimin, përmirësimin e kushteve të punës, si dhe përballimin e shpenzimeve për vjeljen e taksës.

Neni 9

(Shtuar shkronja “q”, dhe ndryshuar shkronjat “c”, “ç” dhe “e” me ligjin 8581, datë 17.2.2000; ndryshuar shkronja “j” me ligjin nr. 8651, datë 28.7.2000; shtuar shkronja “r” me ligjin nr. 8713, datë 15.12.2000; ndryshuar shkronjat “e”, “g” dhe “q” të pikës “A” me ligjin nr. 8840, datë 11.12.2001; shfuqizuar shkronja “o” e pjesës “A” me ligjin nr. 8858, datë 14.2.2002; shtuar shkronjat “rr”, “s” dhe “sh” me ligjin nr. 8915, datë 27.6.2002)

Sipas llojit të taksave organet, që ngarkohen me nxjerrjen e taksave, janë:

A. Për taksat kombëtare:

a. Për taksat portuale ngarkohet kapiteneria e porteve, e cila i vjel këto taksa drejtpërdrejt ose nëpërmjet agjencive detare, shtetërore ose private.

b. Për taksat për shërbime konsullore ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Rendit Publik, sipas ndarjes që do të përcaktohet me udhëzim të veçantë.

c. Për taksën vjetore të tonazhit të automjeteve për aks ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

ç. Për vjeljen e taksës së regjistrimit të përvitshëm të automjeteve ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Të ardhurat nga kjo taksë përdoren, kryesisht, për përmirësimin e sistemit të sinjalizimit rrugor.

Drejtoria e Qarkullimit Rrugor, pranë Ministrisë së Rendit Publik ndërmjet degëve të qarkullimit rrugor në rrethe bën kontrollin e vjeljes së taksës së regjistrimit të përvitshëm të automjeteve dhe të taksës së tonazhit për aks.

d. Për taksën e qarkullimit të automjeteve të huaja ngarkohen degët e doganave, në pikat e kalimit kufitar.

dh. Për vjeljen e taksës për importimin e automjeteve të përdorura ngarkohen degët doganore në rrethe.

e. Për taksën për pajisje me leje drejtimi për drejtim automjeti, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

f. Për taksën për përdorimin e aparateve radiotelevizive ngarkohen zyrat e pagesës së energjisë elektrike.

g. Për taksën për përdorimin e numrit telefonik, kabllor e celular, ngarkohen operatorët përkatës që operojnë në Republikën e Shqipërisë.

gj. Për taksën për kryerjen e veprimeve e të shërbimeve nga administrata gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, të prokurorisë, noteria dhe hipotekat ngarkohen administrata gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, prokuroria, noteria dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

h. Për taksën për regjistrimin në arsimin e lartë ngarkohen universitetet dhe shkollat e tjera të larta.

i. Për taksën për shërbimet e radiokomunikacioneve ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacionit (ERT).

j. Për taksën vjetore për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive ngarkohet Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT).

k. Për taksën e kalimit me avion të kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë ngarkohen organet doganore.

l. Për taksën e ushtrimit të veprimtarisë së peshkimit ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Peshkimit.

ll. Për taksën për pajisjen me pasaportë lundrim për person ngarkohet kapiteneria e porteve.

m. Për taksën për ushtrimin e lotarive të konkurseve parashikuese dhe të lojërave të fatit, ngarkohet Ministria e Financave.

n. Për taksën e akteve dhe të pullës ngarkohen zyrat e gjendjes civile.

nj. Për vjeljen e taksës për ulje-ngritjen e avionëve dhe qëndrimin e tyre në aeroport dhe të taksës së mbikalimeve ajrore mbi territorin e Republikës së Shqipërisë ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil, nëpërmjet ndërmarrjeve të saj, Albtransportit dhe Agjencisë Kombëtare të Trafikut Ajror (ANTA).

Të ardhurat nga taksa për ulje-ngritjen e avionëve dhe qëndrimin e tyre në aeroport dhe taksa e mbikalimeve ajrore të avionëve mbi territorin e Republikës së Shqipërisë përdoren kryesisht për mirëmbajtjen dhe modernizimin e aeroportit të Rinasit ose të aeroporteve të tjera.

o. Shfuqizuar.

Të ardhurat nga vjelja e kësaj takse do të jenë për Ministrinë e Rendit Publik, Ministria e Drejtësisë dhe Ministrinë e Mbrojtjes.

p. Për vjeljen e taksës së rentës minerare ngarkohen organet tatimore dhe Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

q. Për taksën për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasurinë e luajtshme (automjetet) ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

r) Për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës të pronësisë për pasuritë e paluajtshme ngarkohen zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Taksa paguhet nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet pa provuar pagimin e taksës pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

rr. Për mbitaksën për importet e taksueshme ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të saj.

s. Për taksën mbi konsumin e karburantit ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të saj, për gazoilin, benzinën dhe benzolin e importuar, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për prodhuesit vendas të benzinës, gazoilit dhe benzolit.

sh. Për taksën vjetore nga tatimpaguesit e TVSH-së, për ndërtimin e Rrugës Durrës-Kukës, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet degëve të saj.

B. Për taksat vendore:

a. Për taksën për fjetjen në hotel të të huajve ngarkohen hotelet, pensionet shtetërore ose private të nxjerrin vlerën e saj dhe, mbi bazën e bashkërendimit me sektorin përkatës të organit të pushtetit vendor, të derdhen detyrimin në buxhetin vendor, jo më vonë se data 10 e muajit pasardhës.

b. Për vjeljen e taksës së pastrimit, largimit dhe kompostimit të mbeturinave caktohen degët e shitjes së energjisë elektrike në rrethe. Bashkia ose komuna, në fillim të çdo viti, dërgon pranë kësaj dege listën e plotë të subjekteve, që janë objekt i kësaj takse, si dhe masën e taksës për çdo subjekt. Dega e shitjes së energjisë elektrike bën vjeljen e taksës në bazë të këtyre listave përnjëherësh për gjithë vitin, por jo më vonë se tremujori i parë i çdo viti. Shumat e ngarkuara derdhen në degën e thesarit të rrethit, për llogari të buxhetit përkatës vendor.

c. Për vjeljen e taksës së tregut për zënie vendi caktohen bashkia ose komuna, ku kryhet veprimtaria. Agjenti ose organi i caktuar nga komuna a bashkia përcakton dhe vjel taksën, kundrejt biletës, për çdo subjekt, në raport me sipërfaqen e zënë, duke e derdhur atë çdo ditë në arkën e bashkisë apo të komunës.

Në rastet kur zbatohet zënie vendi me karakter të përhershëm (një muaj deri në një vit) organizohet ankandi i hapur me subjektet që janë të interesuara për të tregtuar në vendet e caktuara, duke marrë për vlerë fillestare çmimet ditore, të përcaktuara më sipër dhe fituesve u

bëhet vlerësimi i taksës së vendit, sipas vlerës përfundimtare, ditore, shumëzuar me numrin e ditëve, për të cilin është kryer ankandi. Pagesa, në këtë rast, u bëhet inspektorëve ose agjentëve tatimorë, të caktuar nga bashkia a komuna me prenotim, jo më pak se një herë në muaj, në fillim të çdo muaji. Me këtë rast bashkia a komuna lidh kontratë me subjektin fitues.

ç. Për vjeljen e taksës për gjueti dhe peshkim amator ngarkohet shoqata e gjuetarëve dhe peshkatarëve, e cila bën arkëtimin e taksës në çastin e dhënies së lejes të ushtrimit të gjuetisë dhe të peshkimit amator, sipas zonave të miratuara nga Ministria e Bujqësisë e Ushqimit.

d. Për taksën e tabelës ngarkohen bashkitë e komunat të bëjnë vjeljen e saj për subjektet që kryejnë veprimtarinë e tyre në territorin e bashkisë ose komunës. Çdo subjekt, që i nënshtrohet kësaj taksë, është i detyruar të vendosë tabelën e emërimit të vet në objektin ku kryen veprimtarinë dhe të paguajë detyrimin e përcaktuar pranë bashkisë a komunës brenda muajit janar të çdo viti.

Përfshihen nga kjo taksë vetëm subjektet që kryejnë veprimtari ambulatorë.

dh. Për vjeljen e taksës së mbajtjes së qenve të luksit ngarkohen zyrat e veterinarisë, në bashki e komuna, të cilat bëjnë vjeljen e taksës me dhënien e certifikatës përkatëse.

e. Për taksën e ndërtimeve të reja ngarkohen zyrat e urbanistikës të bëjnë përcaktimin e saj, sipas objektit të miratuar me dhënien e lejes së ndërtimit. Shuma derdhet në degët e thesarit, e cila bën kalimin e saj në buxhetin e organit që ka bërë miratimin e lejes së ndërtimit.

ë. Për taksën e regjistrimit për veprimtari të ndryshme ngarkohen degët e tatimeve dhe taksave në rrethe që në çastin e regjistrimit të subjektit pranë tyre, të llogarisin dhe të arkëtojnë detyrimin e përcaktuar për llogari të pushtetit vendor. Kjo taksë paguhet një herë, me çeljen e veprimtarisë ekonomike.

f. Për taksën 1 për qind të xhiros bashkitë a komunat bëjnë llogaritjen e saj për çdo subjekt, që i nënshtrohet kësaj takse, mbi bazën e xhiros vjetore nga kasat regjistruese. Në pamundësi për të marrë të dhënat nga kasat për shkaqe objektive, rezultati nxirret nga masa e tatimit paraprak, të përcaktuar nga degët e tatimeve e të taksave në rrethe, sipas raportit të ndarë në përqindje. Subjektet, me marrjen e njoftimit, për detyrimin që kanë për taksën 1 për qind të xhiros, bëjnë likuidimin e saj pranë bashkisë ose komunës, që u ka caktuar masën e detyrimit fiskal, çdo tremujor, por jo më vonë se data 15 e muajit pasardhës.

g. Për taksën e regjistrimit familjar në vendbanimin e ri, çdo kryefamiljar, me ndryshimin e vendbanimit, është i detyruar të paraqitet pranë zyrës së gjendjes civile, të bashkisë a komunës, ku përfshihet vendbanimi i ri, për të bërë pagesën e taksës së mësipërme. Punonjësi i gjendjes civile pajis kryefamiljarin me dokument, që vërteton pagesën e kryer.

gj. Për taksën e reklamës ngarkohen bashkitë e komunat ta vjelin atë nga subjekte që vendosin reklamat brenda territorit të tyre.

h. Për vjeljen e taksës së parkimit të automjeteve ngarkohen bashkitë e komunat.

i. Për vjeljen e taksës për çdo bagëti të therrur ngarkohen komunat e bashkitë.

Në raste të veçanta këshillat e rretheve, bashkive dhe komunave kanë kompetencë të caktojnë edhe subjekte të tjera, jashtë atyre të përmendura më sipër, shtetërore apo private, fizike a juridike, të bëjnë vjeljen e taksave vendore, që ato kanë në kompetencë të drejtpërdrejtë për t'i vjelë. Në këto raste subjekteve, që do të shërbejnë si agjentë tatimorë, u lihet deri 11 për qind e shumës së arkëtuar, duke kryer më parë ankand të hapur me ato subjekte ose persona, që janë të interesuar për të bërë vjeljen e taksave vendore. Kufi maksimal, në këtë rast, do të shërbejë niveli 11 për qind. Me përcaktimin e agjentit tatimor, që do të vjelë taksat vendore, rrethi, bashkia a komuna lidh kontratën për vjeljen e taksave.

KREU IV

PËRJASHTIMET NGA PAGIMI I TAKSAVE KOMBËTARE DHE VENDORE

Neni 10

(Shtuar togfjalësh në pikën 14 dhe pika 15 me ligjin nr. 8519, datë 30.7.1999; shtuar pika 15 me ligjin nr. 8713, datë 15.12.2000; shtuar fjalë në fund të pikës 16 dhe pikat 17, 18 dhe 19 dhe shfuqizuar pika 5 dhe 14 me ligjin nr. 8840, datë 11.12.2001)

1. Nga pagimi i taksës së akteve dhe të pullës përjashtohen:
 - veprimet zyrtare, që kërkohen nga autoritetet e huaja, me kusht reciprociteti;
 - regjistrimi i lindjeve dhe i vdekjeve, si dhe shënimet në regjistrat e gjendjes civile.
2. Përjashtohen nga pagimi i taksës së regjistrimit në shkollat e larta studentët jetimë.
3. Përjashtohen nga pagimi i taksave konsullore:
 - Personat, që janë pajisur me pasaportë diplomatike dhe shërbimi.
 - Personat e organizatave bamirëse e filantropike.
 - Punonjësit e Kryqit të Kuq dhe të Ligës Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq.
 - Shtetasit e huaj, me kombësi shqiptare.
 - Shtetasit me dy nënshtetësi, shqiptare dhe të huaj.
 - Personat që shoqërojnë mjete me ndihma humanitare, në bazë të marrëveshjeve ose të dërguara nga organizatat bamirëse, institucionet e ndryshme, individë të veçantë etj.
 - Rastet e vdekjeve jashtë shtetit të shtetasve shqiptarë.
 - Në rastet e kërkuara nga autoritetet e larta zyrtare, të huaja, nëse garantohet parimi i reciprocitetit.
4. Nga pagimi i taksës së kalimit me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë përjashtohen :
 - a) personat që janë të pajisur me pasaportë diplomatike e shërbimi, si dhe anëtarët e delegacioneve të huaja presidenciale e qeveritare;
 - b) personat e organizatave bamirëse e filantropike;
 - c) punonjësit e Kryqit të Kuq dhe të Ligës Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq;
 - ç) anëtarët e familjeve të përfaqësuesve diplomatikë, të akredituar në Republikën e Shqipërisë, që jetojnë bashkërisht;
 - d) anëtarët e personelit të misionit diplomatik, të akredituar në vendin tonë, që punojnë në shërbimin administrativ dhe teknik të misionit, si dhe anëtarët e familjeve të tyre;
 - dh) personeli i avionit dhe personeli i shoqërive ajrore, në bazë të reciprocitetit;
 - e) fëmijët që janë të pajisur me gjysmë biletë;
 - f) për shtetasit shqiptarë, që shkojnë me shërbim jashtë shtetit, pagesa e taksës do të përballohet nga institucioni ose ndërmarrja shtetërore, e cila i dërgon me shërbim.
5. Shfuqizuar.
6. Nga pagimi i taksës për shërbimet e radiokomunikacioneve përjashtohen :
 - a) përfaqësitë diplomatike, të akredituara në Shqipëri;
 - b) organizatat bamirëse dhe filantropike, të regjistruara në vendin tonë.
7. Përjashtohen nga pagimi i taksës për fjetjen në hotel të të huajve grupet turistike, që vijnë nëpërmjet agjencive turistike ose institucioneve të tjera dhe që paguajnë nën 30 (tridhjetë) dollarë USA për çdo ditë qëndrimi.
8. Përjashtohen nga pagimi i taksës së pastrimit familjet që banojnë në fshat, si dhe të gjitha institucionet shkollore dhe konviktet shtetërore të shkollave.
9. Përjashtohen nga pagimi i taksës për aparatet radiotelevizive të gjitha institucionet shkollore dhe konviktet shtetërore të shkollave, si dhe institucionet shëndetësore, shtetërore.
10. Përjashtohen nga taksa e qarkullimit të automjeteve të huaja :
 - a) automjetet e huaja, që sjellin ndihma humanitare, falas;
 - b) mjetet që qarkullojnë me leje-kalimi pa pagesë të taksave rrugore, mbi bazën e reciprocitetit;
 - c) mjetet e përfaqësive diplomatike, shoqatave bamirëse.

11. Përfshihen nga pagimi i taksave portuale :

a) anijet që transportojnë ndihma humanitare në Republikën e Shqipërisë:

- anijet e shërbimeve detare në porte;

- anijet luftarake, spitalore, kabëllmbajtëse, si dhe anijet bazë dhe ato që u shërbejnë atyre për zonat e kërkimit e të shfrytëzimit të naftës në det.

b) Për anijet që prekin portin e Durrësit, taksat portuale zbatohen në masën qind për qind, kurse për anijet që prekin portet e Vlorës, Sarandës, Shëngjinit dhe pikën e benzinsjellësit në Vlorë, taksat portuale zbatohen në masën 20 për qind më të ulta.

c) Për anijet e personave fizikë dhe juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, taksat portuale zbatohen :

- me 50 për qind zbritje për anijet me flamur shqiptar;

- me 20 për qind zbritje për anijet me flamur të huaj.

ç) Anijet me flamur shqiptar të personave fizikë a juridikë, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, që kryejnë transport të brendshëm detar dhe të peshkimit, paguajnë taksën e anijes një herë, në preken e parë të çdo porti shqiptar, dhe nuk paguajnë në hyrjet pasuese, gjatë vitit kalendarik.

12. Përfshihen nga pagimi i taksës për ulje-ngritjen e avionëve dhe qëndrimin e tyre në aeroport :

a) Avionët që transportojnë ndihma humanitare, shtetërore dhe të shoqërive bamirëse.

b) Avionët që kryejnë detyra teknike për kalibrim pajisjesh lundruese, për llogari të Drejtorisë së Aviacionit Civil, si dhe avionët e kërkim- shpëtimit e spitalore.

c) Avionët ushtarakë, që nuk kryejnë veprime tregtare (ngarkim-shkarkim mallrash e udhëtarësh).

ç) Avionët ushtarakë, që vijnë në Shqipëri në kuadrin e dërgimit të ndihmave humanitare, falas, për vendin tonë.

d) Avionët, që vijnë për të marrë ose për të sjellë delegacione të larta shtetërore, të kryesura nga Presidenti i Republikës, Kryeministri ose delegacione të larta ushtarakë.

13. Përfshihen nga pagimi i taksave të mbikalimeve ajrore në territorin e Republikës së Shqipërisë avionët ushtarakë.

14. Shfuqizuar.

15. Përfshihen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës të pronësisë për pasuritë e paluajtshme të gjitha sipërfaqet e shitura nga Enti Kombëtar i Banesave, Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore.

17. Përfshihen nga pagimi i taksës vjetore për regjistrimin e përvitshëm të automjeteve, mjetet në pronësi të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare që gëzojnë statusin diplomatik, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit.

18. Përfshihen nga pagimi i taksës vjetore të tonazhit për aks:

a) Mjetet në pronësi të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare që gëzojnë statusin diplomatik, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit.

b) Automjetet në pronësi të personave, fizikë ose juridikë, të cilët deklarojnë brenda muajit janar të vitit në vazhdim, se nuk do të qarkullojnë për vitin kalendarik, vetëm pasi të kenë dorëzuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor targën dhe lejen e qarkullimit.

19. Përfshihen nga pagimi i taksës për pajisjen me leje drejtimi për drejtim automjeti, personeli i misioneve diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit.

KREU V PËRGJEGJËSIA DHE SHKELJET

Neni 11

Përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme :

- a) refuzimi dhe mospagimi i taksave kombëtare dhe vendore;
- b) falsifikimi i të dhënave dhe i dokumenteve bazë për llogaritjen e taksave;
- c) shmangia në çdo formë tjetër dhe mosderdhja në afat e taksave kombëtare dhe vendore;
- ç) pengimi apo mosdhënia e ndihmës inspektorëve të taksave, për kryerjen e kontrollit ndaj agjentëve tatimore.

Neni 12

(Ndryshuar fjalë me ligjin nr. 8508, datë 7.7.1999; shtuar paragrafi I dytë me ligjin nr. 8713, datë 15.12.2000)

Shkeljet e parashikuara në nenin 11 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale quhen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga inspektorët e ngarkuar për kontrollin e vjeljen e taksave, kombëtare dhe vendore, 5 000 (pesë mijë) deri 20 000 (njëzet mijë) lekë, duke e marrë taksën në vlerën e saj të plotë.

Për taksën e tonazhit për aks dhe për taksën e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve, afati i fundit i vjeljes së këtyre taksave është data 31 mars. Pas kësaj date Policia e Qarkullimit Rrugor dhe Policia Tatimore kanë të drejtë të bllokojnë mjetin, deri në pagesën e taksës.

Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masës administrative bëhen në përputhje me ligjin nr.7681, datë 4.3.1993 "Për administrimin e tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë".

Neni 13

Organi ekzekutiv i pushtetit vendor, që përfiton nga taksa, ka, gjithashtu, të drejtë :

1. Në rastet kur nuk paguhet taksa e pastrimit, pezullohet veprimtaria private dhe vendoset sekuestri deri në vlerën e taksave të papaguara. Për familjet që janë në marrëdhënie pune, lajmërohet institucioni ku punon taksëpaguesi dhe ndalohet paga deri në vlerën e plotë të taksës së papaguar.
 2. Largimin me forcë nga vendi i personave që nuk paguajnë taksën e tregut.
 3. Pezullimin e veprimtarisë për personat që nuk paguajnë taksën e reklamës, taksën e tabelës, taksën e regjistrimit të veprimtarive të ndryshme, taksën 1 për qind të xhiros etj.
 4. Të pezullojë veprimtarinë, nëse ka vonesë në likuidimin e taksës së fjetjes në hotel të të huajve, të mbyllë hotelin dhe të vendosë sekuestrin në vlerën e taksës së papaguar.
 5. Të bëjë sekuestrimin e mishit të therrur, për mospagimin e taksës së therjes.
 6. Të heqë lejen e gjuetisë dhe të peshkimit, në rastet kur nuk paguhet taksa e gjuetisë dhe e peshkimit amator.
 7. Të mos japë lejen e ndërtimit të objektit, nëse nuk paguhet taksa për ndërtime të reja.
- Në rast përsëritjeje zbatohen dispozitat e ligjit nr.7967, date 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 14

Ngarkohet Ministria e Financave, së bashku me ministritë përkatëse, të nxjerrë

udhëzime për zbatimin e këtij ligji.

Neni 15

Ligji nr.7777, datë 22.12.1993 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë" dhe të gjitha ndryshimet që i janë bërë këtij ligji, shfuqizohen.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2287, datë 31.12.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

LIDHJA NR.1 NIVELI I TAKSAVE PORTUALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

	Taksa në dollarë USA	
	Për çdo ton neto të regjistrir të anijeve	Gjithsej për çdo anije
Lloji i taksave		
Taksa Portuale		
1. Takse e anijes:		
a) Për anije që ngarkojnë e shkarkojnë mallra të përgjithshme	0.4	
b) Për anijet që ngarkojnë dhe shkarkojnë mallra të lëngshme	0.6	
c) Për anijet traget RO/RO dhe të udhëtarëve	0.35	
d) Për anijet sportive,jahte		
- deri 30 TRN		15
- nga 31 deri 70 TRN		30
2. Taksë feneri		
- për anijet deri në 200 TRN	0.10	
- për anijet nga 201 deri 500 TRN		20

- për anijet mbi 501 TRN 50

3. Taksë për formalitetet e kryera nga organet e shëndetësisë, kapitenerisë së porteve dhe autoritetet e tjera:

- për anijet deri në 200 TRN	0.25	
- për anijet nga 201 deri 500 TRN		100
- për anijet nga 501 deri 2000 TRN		180
- për anijet nga 2001 deri 4000 TRN		210
- për anijet mbi 4001	300	

4. Anijet që ngarkojnë ujë për eksport në pikat jashtë porteve, paguajnë taksa portuale gjithsej në masën 300 dollarë amerikanë për çdo rast furnizimi.

5. Anijet e huaja i paguajnë taksat portuale në valutë lirisht të konvertueshme, kurse anijet e personave juridikë a fizikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë paguajnë në valutë ose në lekë në raport me realizimin e të ardhurave.

6. Taksa portuale paguhen në prekjën e parë të çdo porti shqiptar, pavarësisht se anija do të shkojë për veprime tregtare dhe në porte të tjera shqiptare në të njëjtin rejs.

LIDHJA NR.2

TAKSAT PËR SHËRBIMET KONSULLORE

(Shtuar pika 9 me ligjin nr. nr. 8581, datë 17.2.2000; ndryshuar pika 7 me ligjin nr. 8713, datë 15.12.2000;)

I. Taksat për lëshimin e vizave dhe dokumenteve të udhëtimit

1. Për lëshimin e pasaportave të udhëtimit	2000 lekë
2. Për lëshimin e pasaportave të udhëtimit nga përfaqësitë	100 US\$
3. Zgjatja e pasaportës nga përfaqësitë	30 US\$
4. Për leje kalimi	200 lekë
5. Leje kalimi lëshuar nga përfaqësitë	30 US\$
6. Vizë për shtetasit e huaj	Reciprocitet

7. Taksa e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për shtetasit e huaj, që nuk kanë nevojë për vizë, do të jetë sipas reciprocitetit, por jo më shumë se 10 US\$.

II. Taksat për lëshimin, verifikimin e legalizimin e dokumenteve

1. Certifikatë të çdo lloji lëshuar nga përfaqësitë për shtetasit shqiptarë	30 US\$
2. Certifikatë të çdo lloji lëshuar nga përfaqësitë për shtetasit e huaj	Reciprocitet
3. Vërtetim të çdo lloji lëshuar nga përfaqësitë për shtetasit shqiptarë	30 US\$
4. Vërtetim të çdo lloji lëshuar nga përfaqësitë për shtetasit e huaj	Reciprocitet
5. Verifikimi i dokumentit nga përfaqësitë	10 US\$
6. Legalizimi i dokumentit për shtetasit shqiptarë nga Ministria e Punëve të Jashtme	200 lekë

6/1. Taksa e vizës për shtetasit e huaj që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë me grupe turistike nëpërmjet shoqërive turistike 10 USD

7. Legalizimi i dokumentit nga përfaqësitë për

shtetasit shqiptarë 30 US\$

7/1. Taksa e hyrjes së shtetasve të huaj që nuk kanë nevojë për vizë dhe që hyjnë në territorin e Republikës Shqiptare me grupe turistike nëpërmjet shoqërive turistike 10 USD

Kjo taksë nuk zbatohet për periudhën 1 maj deri më 1 nëntor.

8. Grupet turistike me shtetas të shteteve që, sipas parimit të reciprocitetit, nuk paguajnë taksë vize ose taksë hyrje, nuk i nënshtrohen taksave të përmendura në pikat 6/1 dhe 7/1.

8. Legalizimi i dokumentit për shtetasit e huaj Reciprocitet

9. Turistët individë njëditorë dhe ata të organizuar në grupe turistike njëditore nuk paguajnë taksë vize ose taksë hyrjeje.

Nuk i nënshtrohen pagimit të kësaj takse të gjithë turistët ditorë, të organizuar në grupe.

III. Taksat për lëshimin e përpilimin e akteve të tjera noteriale dhe përkthimin e dokumenteve nga përfaqësitë

1. Përpilimi i deklaratave, autorizimeve, testamenteve
kontratave, garancive dhe prokurave të posaçme nga
përfaqësitë 20 US \$/faqe
2. Vërtetimi i dublikatave dhe i kopjeve 20 US \$/faqe
3. Përkthimi i dokumenteve 10 US \$/faqe

Shënim: Me termin përfaqësi kuptohet përfaqësia diplomatike apo konsullore jashtë shtetit.

Taksa mund të arkëtohet edhe në monedhën e vendit duke patur parasysh kursin e këmbimit.

LIDHJA NR.3

(Ndryshuar me ligjin nr. nr. 8581, datë 17.2.2000; nr. 8840, datë 11.12.2001)

TAKSAT VJETORE TË TONAZHIT PËR AKS TË MJETEVE

Nr.	Tipi i mjetit	Masa e taksës për një aks në lekë
1.	Autoveturë dhe mikrobus me më shumë se (4 + 1) dhe me më pak ose barabartë me (8 + 1) vende	5000
2.	Autobus me më pak ose i barabartë me (32 + 1) vende	10000
3.	Autobus me më pak ose i barabartë me (42 + 1) vende	13000
4.	Autobus me më shumë se (42 + 1) vende	15000
5.	Furgon dhe kamionçinë me peshë maksimale të autorizuar më të vogël ose të barabartë me 3 tonë	5000
6.	Furgon dhe kamion me peshë maksimale të autorizuar mbi 3 dhe deri të barabartë me 3,5 tonë	10000
7.	Kamion me peshë maksimale të autorizuar mbi 3,5 dhe deri ose të barabartë me 7,5 tonë	15000

8.	Kamion me peshë maksimale të autorizuar mbi 7,5 dhe deri ose të barabartë me 18 tonë	18000
9.	Kamion me peshë maksimale të autorizuar mbi 18 tonë	23000
10.	Mjete për punime ndërtimi dhe toke (traktor rrugor, karkalec etj.) me peshë maksimale të autorizuar më të vogël ose të barabartë me 7,5 tonë	15000
11.	Mjete për punime ndërtimi dhe toke (traktor rrugor, fadromë etj.) me peshë maksimale të autorizuar mbi 7,5 tonë	18000
12.	Mjete ndërtimi (autovinça, autobetoniere etj.) me peshë maksimale të autorizuar deri ose të barabartë me 7,5 tonë	20000
13.	Mjete ndërtimi (autovinça, autobetoniere etj.) me peshë maksimale të autorizuar mbi 7,5 dhe deri ose të barabartë me 18 tonë	24000
14.	Mjete ndërtimi (autovinça, autobetoniere, etj.) me peshë maksimale të autorizuar mbi 18 tonë	30000
15.	Rimorkio me peshë maksimale të autorizuar më të vogël ose të me 7 tonë	7500
16.	Rimorkio me peshë maksimale të autorizuar mbi 7 tonë	10000

Shënim:

Vlerat e taksave në tabelën e mësipërme janë vetëm për një aks. Pagesa e plotë e taksës do të jetë sa vlera e taksës për një aks shumëzuar për numrin e akseve.

LIDHJA NR.4 TAKSA E QARKULLIMIT TË AUTOMJETEVE TË HUAJA

Në USD

Për veturat e udhëtarëve për çdo ditë apo pjesë të ditës	1
Për mikrobuzat	2
Për autobuzët për udhëtarë për çdo km në tokën shqiptare. (Kjo taksë nuk mund të jetë më e vogël se 5 \$ për çdo ditë)	0.002
Për kamionët e rimorkiot e kamionëve për çdo ton /km në tokën shqiptare (Kjo taksë nuk mund të jetë më e vogël se 8\$ për çdo ditë).	0.02
Kur automjetet kalojnë pa ngarkesë paguajnë 50 % të taksës.	

LIDHJA NR.5 TAKSAT VJETORE PËR REGJISTRIMIN E PËRVITSHËM TË AUTOMJETEVE (Ndryshuar me ligjin nr. nr. 8581, datë 17.2.2000; nr. 8840, datë 11.12.2001)

LIDHJA NR. 5
TAKSAT VJETORE PËR REGJISTRIMIN E PËRVITSHËM TË MJETEVE

Nr.	Tipi i mjetit	Masa e taksës në lekë
1.	Motomjete	600
2.	Autoveturë me më pak ose e barabartë me (4 + 1) vende	2400
3.	Autoveturë dhe mikrobus me më shumë se (4 +1) dhe me më pak ose e barabartë me (8 +1) vende	4800
4.	Autobus me më pak ose i barabartë me (32 + 1) vende	6000
5.	Autobus me më pak ose i barabartë me (42 + 1) vende	7200
6.	Autobus me më shumë se (42 + 1) vende	8400
7.	Autobus artikular me më shumë se (42 + 1) vende	9000
8.	Furgon dhe kamion me peshë maksimale të autorizuar deri në 3,5 tonë	3600
9.	Kamion me peshë maksimale të autorizuar mbi 3,5 dhe deri ose e barabartë me 7,5 tonë	4800
10.	Kamion me peshë maksimale të autorizuar mbi 7,5 dhe deri ose e barabartë me 18 tonë	6000
11.	Kamion me peshë maksimale të autorizuar mbi 18 tonë	8000
12.	Mjete për punime ndërtimi dhe toke (traktor rrugor, karkalec etj.) me peshe maksimale të autorizuar më të vogël ose të barabartë me 7 5 tonë	3000
13.	Mjete për punime ndërtimi dhe toke (traktor rrugor, fadromë, autovinç etj.) me peshë maksimale të autorizuar mbi 7,5 tonë	3600
14.	Rimorkio me peshë maksimale të autorizuar më të vogël ose të barabartë me 7 tonë	3000
15.	Rimorkio me peshë maksimale të autorizuar mbi 7 tonë	4000

Lidhja Nr.6
**TAKSA PËR VEPRIMET DHE SHËRBIMET QË KRYHEN NGA ADMINISTRATA
 GJYQËSORE, E MINISTRIA E DREJTËSISË, NOTERIA DHE ZYRAT E REGJISTRIMIT
 TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PROKURORIA DHE ZYRAT E GJENDJES CIVILE**

në %	Masa e taksës në/lekë	
A. Taksa për veprime e shërbime që kryhen nga administrata gjyqësore e prokuroria.		
1. Për regjistrimin e personave fizikë e juridike privatë (shtetas shqiptar)	1000	
2. Për regjistrimin e personave juridike privatë (shtetas të huaj)	4500	
3. Për lëshimin e vërtetimit se personi nuk ka pengesa ligjore për pajisjen me pasaportë për jashtë shtetit	100	
4. Për lëshimin nga gjykata të çdo kopje vendimi e çdo dokumenti që kërkohet nga të interesuarit.	100	
5. Për lëshimin e dëshmisë së penalitetit nga zyrat e gjendjes gjyqësore.	100	
6. Për legalizimin e akteve të noterisë nga Ministria e Drejtësisë	100	
7. Kërkesë padi që paraqiten në gjykatë		
- për pension ushqimor	-	
- për vërtetim fakti	100	
- padi për zgjidhje martese	1500	
- padi për pavlefshmëri të veprimeve juridike	1500	
- padi të rrjedhura nga marrëdhënie kontraktore si dhe për shkaktim dëmi me vleftë deri 100000 lekë	500	
me vleftë mbi 100000 lekë		1%
- padi për pjesëtim pasurie	1500	
- padi për kthim në punë	-	
B. Taksë për veprime që kryhen nga përmbaruesi gjyqësor:		
1. Për vënien në ekzekutim të vendimeve e titujve të tjerë ekzekutiv me objekt të pavleftësueshëm	750	

2. Për vënien në ekzekutim të vendimeve
e titujve të tjere ekzekutiv me
objekt të vlefshueshëm:
- kundrejt shtetasve 3%
 - kundrejt personave juridikë 7%

3. Për lajmërimet dhe veprimet e tjera
të përmbaruesit gjyqësor 100
4. Për lëshime nga përmbaruesi gjyqësor
të çdo lloj akti ose dokumenti të
kërkuar nga të interesuarit 100
5. Për vënien në ekzekutim të vendimeve
me objekt pension ushqimor -

C. Taksat për veprimet që kryhen nga zyrat noteriale

1. Përpilimi i testamenteve me akte noteriale 450
2. Përpilimi i testamenteve ollografe (me vërtetim firme) 200
3. Prokura (redaktim)
- të përgjithshme 150
 - të posaçme 150
4. Për lëshimin e kopjeve, shkurtime e pjesë të akteve
të depozituara në zyrën noteriale 150
5. Vërtetim se kopjet ose shkurtime të dokumenteve
janë të njëjta me origjinalin 150
6. Vërtetim përkthimi dhe vërtetim njësisë me origjinalin 100
7. Kontrata për kalim pronësie të pasurisë së luajtshme 700
8. Kontrata për kalim pronësie të pasurisë së paluajtshme 1000
9. Redaktimi i akteve noteriale të ndryshme 150
10. Njoftim dhe kujtese noteriale ose akte të tjera jashtë
gjyqësore 150
11. Legalizim i nënshkrimit të shtetasve në akte
të ndryshme 100
12. Depozitimi i kapitalit themelor për themelimin
e një shoqërie në bazë të ligjit nr.7638,
datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” 300
13. Pranimi për ruajtje të dokumenteve të
personave fizikë dhe juridikë në zyrat noteriale 300
14. Vërtetimi i qënies së një personi dhe qëndrimi i tij
në një vend të caktuar 150
15. Veprime të tjera noteriale 100

*D. Taksat për veprimet që kryhen nga zyrat e
regjistrimit të pasurive të paluajtshme*

1. Kërkesa për regjistrimin e pronësisë së pasurisë
të paluajtshme 300
2. Kërkesa për regjistrimin e pjesëtimit, ndarjes ose
bashkimit të pasurisë së paluajtshme 300
3. Kërkesa për përgatitjen e dokumenteve për në
gjykatë ose organ tjetër administrativ 150

4. Kërkesa për regjistrimin për kalim pronësie, qiraje, nënqiraje 300
5. Kërkesa për regjistrim hipoteke ligjore 150
6. Kërkesa për regjistrim përfshirje hipoteke ligjore 150
7. Kërkesa për regjistrim përfshirjen e një vendimi gjykate a të një akti administrativ 150
8. Kërkesa për regjistrim servituti, marrëveshjeje kufizuese 150
9. Kërkesa për regjistrim për fshirjen e një servituti, marrëveshjeje kufizuese 150
10. Regjistrimi i kërkesave për heqjen dorë nga të drejtat pasurore mbi pasurinë e paluajtshme 100
11. Regjistrimi i kërkesave për fitimin e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme me trashëgimi 300
12. Kërkesa për regjistrimin e veprimeve juridike mbi pasurinë e paluajtshme nga personat fizikë dhe juridikë me banim jashtë shtetit 300
13. Për lëshimin e certifikatave të pasurisë 100
14. Për lëshimin e çdo kopjeje të certifikatës së pasurisë 50
15. Për lëshimin e çdo akti të interesuarve për veprimet hipotekore 50

E. Taksa e akteve dhe e pullës

1. Për lëshimin e certifikatave të gjendjes civile 50
2. Për lëshimin e pasaportave për brenda vendit. 100
3. Për marjen e çdo akti të ometuar ose të zhdukur të gjendjes civile, si dhe për korigjimet e tyre. 50
5. Për regjistrimin e dhënies së shtetësisë 700
6. Për regjistrimin e lënies së shtetësisë 700
7. Për regjistrimin e vendimit të ndërrimit të emrit ose mbiemrit. 700
8. Për çdo lidhje martese 600

LIDHJA NR.7

TAKSAT PËR SHËRBIMET E RADIOKOMUNIKACIONIT (Ndryshuar me ligjin nr. 8713, datë 15.12.2000)

PJESA A

TAKSAT PËR SHËRBIMET PRIVATE TË RADIOKOMUNIKACIONEVE

I. Shërbimi aeronautik

1. Stacion bazë në tokë 10 000 lekë në vit

2. Stacion i lëvizshëm në tokë	7 500 lekë në vit
3. Stacion portativ në tokë	5 000 lekë në vit
4. Terminal satelitor në avion	40 000 lekë në vit
5. Radaret dhe pajisjet e radionavigimit aeronautik për çdo pajisje	3 000 lekë në vit
6. Stacionet e avionit me aftësi ngritëse	
- deri 3 200 kg	5 000 lekë në vit
- mbi 3 200-14000 kg	40 000 lekë në vit
- mbi 14 000 kg	80 000 lekë në vit

II. Shërbimi detar

1. Stacion bregdetar	10 000 lekë në vit për çdo stacion bazë
2. Radarë dhe pajisje radionavigimi	2 500 lekë në vit për çdo pajisje
3. Radio për operacione portuale	1 500 lekë në vit për çdo radio
4. Stacion bazë në anije(HF,VHF,UHF)	5 000 lekë në vit për çdo radio
5. Stacion portativ (VHF) në anije	1 000 lekë në vit për çdo radio.
6.Terminal satelitor në anije INMARSAT	3 000 lekë në vit

III. Shërbimi satelitor

1. Stacion tokësor fiks	
- analog me gjerësi brezi deri 100 kHz	150 000 lekë në vit
- me gjerësi brezi mbi 100 deri 1MFz	500 000 lekë në vit
- me gjerësi brezi mbi 1 MHz	1 200 000 lekë në vit
- dixhital me kapacitet deri 64 kbps	25 000 lekë në vit
deri 2 Mb/s	75 000 lekë në vit
mbi 2Mb/s deri 8Mb/s	300 000 lekë në vit
mbi 8 Mb/s	700 000 lekë në vit
2. Stacion Tokësor i transportueshem (në automjete)	800.000 lekë në vit
3. Stacion portativ VSAT (çantë, valixhe)	30.000 lekë në vit
4. Stacion tokësor i transportueshëm me afat qendrimi deri në një muaj në vendin tonë	60 000 lekë në vit
5. Stacion portativ VSAT (çantë, valixhe) me afat qëndrimi deri 6 muaj në vendin tonë	15 000 lekë në vit

IV. Shërbimi i lëvizshëm në Tokë.

1. Shërbim i lëvizshëm (PMR), në brezin 146 MHz deri 470 MHz
 - A. Sisteme duplex me gjysmë duplex me gjerësi kanali deri 12.5 Khz:

Zona e shërbimit	Lidhje midis dy stacioneve përsëritës	Lidhje stacion fiks me stacion të lëvizshëm dhe/ose stacion i lëvizshëm me stacion të lëvizshëm
deri në 10 km	15 000 lekë në vit	10 000 lekë në vit
mbi 10 deri 30 km	25 000 lekë në vit	20 000 lekë në vit
mbi 30 deri 50 km	55 000 lekë në vit	40 000 lekë në vit
mbi 50 km	80 000 lekë në vit	65 000 lekë në vit

Ky nivel taksash zbatohet për sisteme që kanë deri në 10 stacione të lëvizshëm.

B. Për sisteme të njëjtë me ato të pikës 1.A, por me numër më të madh stacionesh të lëvizshëm, zbatohen taksat e mëposhtme:

- për sistem me 11 deri 25 stacione taksës përkatëse të pikës 1.A i shtohet po ajo vlerë me koeficient reduktimi 0.8

- për sistem me 26 deri 40 stacione taksës së mësipërme i shtohet taksa e pikës 1.A me koeficient reduktimi 0.6

- për sisteme që ka mbi 40 stacione taksës së mësipërme i shtohet taksa e pikës 1.A me koeficient reduktimi 0.4

C. Për sistemet me gjerësi kanali 25 Khz taksa e llogaritur si në 1.A dhe 1.B të shumëzohet me koeficientin 1.5

D. Për sistemet simplekse zbatohen taksat përkatëse të pikave 1.A dhe 1.B me koeficient reduktimi 0.5

2. Sistem "trunk " kombëtar

- 100 000 lekë në vit për çdo kanal me gjerësi 12.5 kHz

- 150 000 lekë në vit për çdo kanal me gjerësi 25 kHz

3. Sistemi "trunk" rajonal

- 30 000 lekë në vit për çdo kanal me gjerësi 12.5 kHz

- 40 000 lekë në vit për çdo kanal me gjerësi 25 kHz

4. Sistem TETRA

-50 000 lekë në vit për sistem kombëtar për çdo kanal 25 Khz

- 20 000 lekë në vit për sistem rajonal për çdo kanal 25 Khz

V. Shërbimi fiks për operatorët e telekomunikacioneve.

Lidhje dy drejtimshe:

Sistem në brezin deri 80 MHz

80 000 lekë në vit për çdo kanal 3 kHz

Sistem në brezin 80-500 MHz

40 000 lekë në vit për çdo kanal 25 kHz

Sistem në brezin 500-1000 MHz

25 000 lekë në vit për çdo kanal 200 kHz

50 000 lekë në vit për çdo kanal mbi 200 kHz.

Sistem në brezin mbi 1000 MHz

a) analog:	
për çdo kanal me gjerësi deri 1 MHz	30 000 lekë në vit
për çdo kanal me gjerësi deri 10 MHz	40 000 lekë në vit
për çdo kanal me gjerësi mbi 10 MHz	60 000 lekë në vit
b) dixhital:	
për kapacitet deri 128 kb/s	5 000 lekë në vit
për kapacitet deri 2 Mb/s	20 000 lekë në vit
për kapacitet deri 8 Mb/s	30 000 lekë në vit
për kapacitet deri 34 Mb/s	40 000 lekë në vit
për kapacitet mbi 34 Mb/s	50 000 lekë në vit

Shënime :

*Me lokal do të kuptohet mbulimi i territorit në nivel rrethi

*Me rajonal do të kuptohet mbulimi i territorit të disa rretheve.

*Me kombëtar do të kuptohet mbulimi i mbi 50% të territorit shqiptar.

PJESA B

TAKSAT PËR SHËRBIMET PUBLIKE TË RADIOKOMUNIKACIONEVE

1. Shërbimi fiks tokësor

- Për përdorim jo ekskluziv të frekuencave

Sistem analog (radio-rele)	3 000 lekë / vit për çdo kanal telefonik 3kHz
Sistem dixhital (radio-rele)	1 500 lekë / vit për çdo kanal telefonik 64kb/s
Sistem dixhital (radio rele)	20 000 lekë/vit për çdo link 2Mbit/sek
Sisteme radio të telefonisë rurale	1 000 lekë/vit për çdo kanal telefonik

- Për përdorim ekskluziv të frekuencave në nivel kombëtar

Në brezin UHF	100 000 lekë/vit për çdo 1 Mhz gjerësi brezi të përdorur
Në brezin 1-5 Ghz	60 000 lekë/vit për çdo 1 Mhz gjerësi brezi të përdorur
Në brezin 5-11 Ghz	40 000 lekë/vit për çdo 1 Mhz gjerësi brezi të përdorur
Në brezin mbi 11 Ghz	20 000 lekë/vit për çdo 1 Mhz gjerësi brezi të

përdorur

2. Shërbim fiks satelitor

Sistem analog	5000 lekë/vit për çdo kanal telefonik 3kHz
Sistem dixhital	3000 lekë/vit për çdo kanal telefonik 64 kb/s

3. Shërbim i lajmërimit të personit (Pager)

Lidhje ndërmjet stacioneve fikse (bazë-përsëritës)	40 000 lekë/vit
	për çdo hop radio
Për çdo stacion bazë	30 000 lekë/vit

4. Shërbimi i lëvizshëm telefonik (GSM)

150 000 lekë/vit
për çdo kanal 200 kHz

5. Shërbimi internet

Lidhje me sistem satelitor	10 000 lekë/vit për çdo njësi 64 kb/s
Lidhje me sistem radio-rele	1 500 lekë/vit për çdo njësi 64 kb/s

6. Shërbimi telefonik satelitor (GMPCS) 4 000 USD/vit

LIDHJA NR.8

TAKSA VJETORE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË PESHKIMIT

	Lekë
I. Peshkimi detar (për 1 anije)	
1. Peshkimi detar fundor :	
-anije 160-200 HP	40000
-anije 200-410 HP	50000
-anije mbi 410HP	80000
2. Peshkimi pellagjik me tratavolante	
- anije 160-200 HP	20000
- anije 200-410 HP	30000
- anije mbi 410 HP	40000
3. Peshkimi pellagjik me rrethime	
- anije 80-200	<i>HP10 000 lekë.</i>
20000	
- anije mbi 410 HP	30000
4. Peshkimi pellagjik dhe fundor	
- anije 160- 200 HP	40000
- anije 200- 410 HP	60000
- anije mbi 410 HP	90000
5. Peshkimi me mjete selektive	
- anije 40-80 HP	<i>15 000 lekë</i>
- anije 81-160 HP	<i>25 000 lekë</i>
- anije 161-200 HP	<i>40 000 lekë</i>
- anije 201-410 HP	<i>50 000 lekë</i>
- anije mbi 410 HP	<i>80 000 lekë.</i>
6. Peshkimi i moluskeve bivalvore	60000
(i autorizuar)	

II.Peshkimi artizanal me mjete të lehta:

1.Peshkimi në bregdet (për një sanall dhe me motor deri 40 HP)	<i>7 000 lekë.</i>
2. Peshkimi në lagunat bregdetare:	
- në lagunë (1 lundror)	10000
- në dajlanë (1 peshkatar)	12000
3. Peshkimi në ujëra të brendshme:	
- aktiv (1 lundror) 5000	
- në dajlane e prita (1 peshkatar)	8000
4. Grumbullimi i molusqeve bivalvore me mjete të lehta (gabie)	
për 1 (një) peshkatar	<i>20 000 lekë.</i>

III. Peshkimi sportiv në det

me mjete lundruese për 1 mjet)

40000

Shënim: Për anijet e huaja që do të marrin licence peshkimi në ujërat tona territoriale taksa e lejes së ushtrimit të aktivitetit do të jetë sa dyfishi i anijeve shqiptare.

Nuk i nënshtrohen kësaj takse anijet e autorizuar nga Ministria e Bujqësisë dhe ushqimit (Drejtoria e Peshkimit) që do të peshkojnë për qëllime studimore shkencore.

IV. Akuakultura:

- | | |
|--|-------------|
| 1. Kultivimi i midhjeve për një impiant | 10 000 lekë |
| Kultivimi i peshqve me impiante në det, në liqene, në rezervuarë | 1 000 lekë |
| 3. Akuakulturë me impiante në tokë | 10 000 lekë |

Lidhja Nr 9

NIVELI I TAKSAVE PËR ULJE NGRITJEN E AVIONEVE DHE QËNDRIMIN E TYRE NË AEROPORT

1.Taksat për ulje ngritje të avionit	Dollarë USA
Për avionë deri në 1 ton	25
mbi 1 - 2 ton	35
mbi 2 - 6 ton	70
mbi 6- 10 ton	120
mbi 10-20 ton200mbi 20-30 ton	300
mbi 30-45 ton	400
mbi 45-60 ton	550
mbi 60-80 ton	650
mbi 80-100 ton	700
mbi 100-120ton	800
mbi 120 ton	900
2. Taksat e qëndrimit në aeroport.	
(3 deri në 24 orë)	
deri në 1 ton	8
mbi 1 deri 2 ton	12
mbi 2 deri 6 ton	35
mbi 6 deri 10 ton	40
mbi 10 deri 20 ton	60
mbi 20 deri 30 ton	80
mbi 30 deri 45 ton	100
mbi 45 deri 60 ton	130
mbi 60 deri 80 ton	140
mbi 80 deri 100 ton	150
mbi 100 deri 120 ton	170
mbi 120 e lart	200

- Pësja bazë për pagesën e taksave të mësipërme do të konsiderohet pësja maksimale e ngritjes së avionit (MTOW)

- Kur fluturimet kryhen ditët e djela, festa zyrtare e fetare si dhe jashtë orarit të punës së aeroportit, me përjashtim të avionëve të linjave të rregullta, taksave të mësipërme u bëhet një shtesë 50 %.

- Në rast se avioni që është ngritur nga aeroporti detyrohet të riulet, për shkaqe të kushteve atmosferike apo të difekteve, taksat për uljen e përsëritur do të jenë 50 % më të ulta .

LIDHJA NR.10

(Ndryshuar me ligjin nr. 8651, datë 28.7.2000; shfuqizuar me ligjin nr. 8858, datë 14.2.2002)

LIDHJA NR. LL

TAKSAT VJETORE PËR SHËRBIMET E TRANSMETIMEVE RADIO E TELEVIZIVE *(Shtuar me ligjin nr. 8840, datë 11.12.2001)*

Për transmetuesit ose përsëritësit televizivë analogë tokësorë, radio FM tokësore, radio AM të operatorëve privatë radio e televizivë, kombëtarë e vendorë

1.Për çdo transmetues ose përsëritës televiziv analogjik tokësor

a) me fuqi të rrezatuar deri 10W	1500 lekë në vit
b) me fuqi të rrezatuar deri 100 W	6000 lekë në vit
c) me fuqi të rrezatuar deri 1000W	24000lekë në vit
d) me fuqi të rrezatuar deri 10000W	48000lekë në vit
e) me fuqi të rrezatuar mbi 10000W	60000lekë në vit

2.Për çdo transmetues ose përsëritës radio FM tokësore

a) me fuqi të rrezatuar deri 10 W	300lekë në vit
b) me fuqi të rrezatuar deri 100 W	1200 lekë në vit
c) me fuqi të rrezatuar deri 1000W	4800 lekë në vit
d) me fuqi të rrezatuar deri 10000W	9600 lekë në vit
e) me fuqi të rrezatuar mbi 10000W	12000lekë në vit

3. Në qoftë se një nga transmetuesit ose përsëritësit 1.b, 1.c, 1.d, 1.e, 2.b, 2.c, 2.d, 2.e, mbulon mbi gjysmën e qytetit të Tiranës, atëherë taksa e llogaritur në këto pika shumëzohet me koeficientin 5.

4.Në qoftë se një nga transmetuesit ose përsëritësit 1.b, 1.c, 1.d, 1.e, 2.b, 2.c, 2.d, 2.e, mbulon mbi gjysmën e një qyteti me popullsi mbi 100 000 banorë, atëherë taksa e llogaritur në këto pika shumëzohet me koeficientin 2.

5. Në qoftë se një nga transmetuesit ose përsëritësit 1.b, 1.c, 1.d, 1.e, 2.b, 2.c, 2.d, 2.e, mbulon mbi gjysmën e një qyteti me popullsi 50000 deri 100 000 banorë, atëherë taksa e llogaritur në këto pika shumëzohet me koeficientin 1,5.

6. Në qoftë se transmetuesit ose përsëritësit 1.b, 1.c, 1.d, 1.e, 2.b, 2.c, 2.d, 2.e, mbulojnë dy ose më shumë qytete të cituara në pikat 3, 4, 5, atëherë taksa e llogaritur në këto pika shumëzohet vetëm një herë me koeficientin më të lartë.

7. Për çdo transmetues AM 200 000 lekë në vit.

Operatorët radio dhe/ose televizivë të ritransmetimit të programeve të huaja me përsëritës të licencuar nga KKRT paguajnë vetëm 20% të taksave të përcaktuara më sipër.